

Roli i mësimdhënësit në ligjërimin e letërsisë

*Mustafa Erdem**

Abstrakt

Ky punim parashikon përmbledhje të ideve dhe kërkimeve mbi rolin e mësuesit në mësimdhënien e letërsisë. Letërsia dhe gjuha janë të lidhura ngushtë dhe ky është një fakt që askush nuk mund ta mohojë. Letërsia përbëhet nga gjuha dhe paraqet një nga përdorimet më të shpeshta. Prandaj, është për të besuar që letërsia e gjuhës angleze ndihmon nxënësit në përmirësimin e fushëveprimit në lexim dhe në mënyrën e tyre të të shprehurit. Mësuesit janë lidhja mes nxënësve dhe diturisë. Mësuesit janë udhëheqësit e mësimin dhe mundësojnë nxënësit për të rritur aftësitë e tyre të të mësuarit të pavarur. Mësuesit janë aktorë të rëndësishëm në procesin e të mësuarit dhe ata duhet të inkurajojnë nxënësit që të diskutojnë, imagjinojnë, lexojnë dhe ritregojnë tregimet në mënyrë që të rritet motivimi dhe vlera e letërsisë.

Fjalë kyç: *Letërsi, letërsia e mësimdhënies, gjuhë, mësimi i gjuhës, mësimdhënësi, roli i mësimdhënësit etj.*

Hyrje

Edukimi i mirë ka një rëndësi jetike për të përgatitur një forcë punëtore me kualifikimin e duhur për shekullin në të cilin jetojmë. Përgatitja e individëve, të cilët mendojnë, sjellin ide të reja, mësojnë, shprehin në mënyrë të saktë dhe përdorin aktivisht dijet e tyre në jetë është një nga qëllimet kryesore të edukimit dhe përmirësimit të aftësive gjuhësore; bën të mundur arritjen e këtyre qëllimeve të rëndësishme.

* *Mustafa Erdem (PhD. Cand.), Universiteti i Tiranës.
E-mail: merdem@gulistankosova.com*

Bazuar në English Proficiency Index¹ 58 % e fëmijëve që jetojnë në vendet e Evropës flasin dy gjuhë të huaja, si dhe se mësimdhënies së gjuhës angleze si gjuhë e dytë i vihet një theks i veçantë. Të njëjtën situatë vërejmë edhe në Kosovë, ku numri i studentëve të interesuar për të mësuar gjuhën angleze si gjuhë të dytë po rritet nga dita në ditë. Zhvillimi i madh i teknologjisë së komunikimit e bëri diçka të tillë të mundur dhe, në çdo cep të botës, njerëzit janë të ndërgjegjshëm për zhvillimet që ndodhin shumë larg tyre.

Këto zhvillime kanë bërë që shtetet t'i kushtojnë një rëndësi të veçantë mësimin të gjuhës së huaj.

Fakti që numri i njerëzve që flasin anglishten si gjuhë e dytë e kalon numrin e atyre që e flasin anglishten si gjuhë amtare tregon rëndësinë e edukimit në këtë gjuhë për të huajt.²

Gjuha amtare mësohet në mënyrë të pandërgjegjshme dhe pa shumë përpjekje nga fëmijët. Ato gjithashtu mësojnë një tjetër gjuhë të folur përreth tyre pa pasur nevojën e mësimave deri në moshën 4-5 vjeçare. Për moshat më të mëdha lind nevoja e mësimin të gjuhës së huaj me më shumë përpjekje. Janë bërë një numër i madh kërkimesh gjetjen e metodave dhe teknikave më të mira për të mësuar gjuhën e huaj në mënyrën më efikase. Kështu që, metodat e mësimdhënies po ndryshojnë nga zbulimet e reja që bie koha dhe sa vjen e po përdoren metoda gjithnjë e më të sofistikuara.

¹ *Education first: EF English Proficiency Index 2012*. E qasshme edhe në: <http://www.kernvakengels.nl/english-in-54-countries.pdf>

² Graddol, David. *The Future of English? A guide to forecasting the popularity of the English language in the 21st century*. The British Council. 2000. E qasshme edhe në: <https://microsites.bournemouth.ac.uk/business-postgraduate/files/2014/09/CIGBE-The-Future-of-English.pdf>

Letërsia e mësimdhënies

Ekziston një lidhje e ngushtë në mes të gjuhës dhe letërsisë. Letërsia përbëhet nga gjuha dhe paraqet një nga përdorimet më të shpeshta të gjuhës. Mësuesit duhet ta kuptojnë këtë lidhje dhe duhet të përipiqen më shumë për të ndryshuar metodat tradicionale. Nëse mësimdhënësi dëshiron të largojë barrierat kulturore dhe gjuhësore dhe të bëjë mësimin më të frytshëm ata duhet të përdorin teknikat moderne, materialet audio-vizuele dhe të zhvillojnë shkathhtësitë e sintezave të njohurive në mesin e studentëve. Me ndihmën e materialeve audio-vizuele dhe teknologjisë studentët mund të kenë informacione vizuele në lidhje me vendet e ndryshme, kulturat dhe kombet. Mësuesi dhe studenti mund të gjejë informacione nga interneti për të pajisur veten me informata para se të fillojnë me temën. Për këtë arsye, mësuesit dhe institucionet duhet të kenë perspektivë të re dhe vizion, qasje të re dhe gatishmërinë për të ndryshuar në mënyrë që mësimdhënia dhe mësimi mund të bëhet lehtë, interesant dhe e frytshëm.

Norling³ beson se "mësuesi ka një rol të rëndësishëm në mësimdhënien e gjuhës angleze përmes letërsisë". Një nga prioritetet e para si mësues është të përcaktojë qëllimin e letërsisë së përdorur për qëllime mësimore. A është kjo për shkak se ajo është e nevojshme për nevojat dhe pritshmërinë e studentëve? Apo, thjesht është e detyrueshme për mësuesit që ta kryejnë mësimdhënien nëpërmjet letërsisë? Norling⁴ propozon një pyetësor ose intervistimin e studentëve në mënyrë që të vendoset për qëllimet dhe objektivat e kursit. Kjo është ndoshta një nga idetë e shëndosha. Siç u tha më lart, është

³ Teresa Norling, *Aims and objectives in the teaching of English literature at upper secondary school*. <http://www.diva-portal.org/smash/get/diva2:292256/fulltext01>

⁴ Ibid.

e rëndësishme të krijojnë një program i cili i përshtatet mirë nxënësit, dhe mënyra më e mirë për ta bërë këtë është duke u kthyer kah personazhet kryesore: nxënësit. Së dyti, Norling⁵ thekson se mësuesi është përgjegjës për zhvillimin e aktiviteteve, zbatimin e metodave dhe teknikave të mësimdhënies, si dhe për të përcaktuar nivelet e duhura të gjuhës. Duke e bërë këtë, mësuesit janë afër që të krijojnë tema të përshtatshme të kurrikulës dhe objektivave dhe të jenë më afër për t'i arritur qëllimet e tyre gjatë gjithë vitit shkollor. Pas kësaj, Norling⁶ beson se hapi i tretë duhet të jetë zgjedhja e teksteve, të cilat mësuesi duhet patjetër t'i marrë në konsideratë: aftësinë gjuhësore të studentëve, interesat, gjininë, moshën, etj. Ky është një hap i shëndetshëm pasi nuk merr parasysh nevojat e nxënësve në mënyrë individuale, por vë në dukje praninë e secilit dhe çdo nxënës, si dhe pritshmërinë e tyre.

Norling këshillon që:

Për shembull, në nivelet elementare, nxënësve duhet t'u jepen tregime të thjeshta apo veçanërisht të shkruara. Megjithatë, në nivelet e avancuara, nxënësve u jepet letërsia në formën e vet origjinale në mënyrë që ata të mund të zhvillojnë aftësitë e tyre letrare në gjuhën e caktuar. Për ta shprehur me fjalë të tjera, nxënësit mësojnë përdorimin e gjuhës në mënyrën figurative dhe në atë të përditshme, e cila është synuar në tekstet letrare dhe ndeshen me zhanret e ndryshme të letërsisë në nivele të avancuara. Duke vëzhguar se si personazhet në një dramë ose në një tregim të shkurtër përdorin mënyrën e të folurit siç është e qeshura, metafora, metonimia, etj, në mënyrë që të shprehin qëllimin e tyre komunikues, nxënësit mësojnë se

⁵ Ibid.

⁶ Ibid.

si të shkruajnë në gjuhën angleze më qartë, si të jenë më kreativë, dhe të ndihen më të fortë në përvetësimin e tyre.⁷

Me fjalë të tjera, Norling përpiket thjesht që të shpjegojë se, ashtu siç nxënësve të nivelit elementar u jepen tregime që më së shumti janë të shkruara veçanërisht për ta ose që u drejtohen në mënyrë specifike nevojave të tyre, nxënësve të nivelit të avancuar u duhen dhënë tekste, të cilat janë origjinale në formë, por që u japin atyre mundësi që të mundë të zhvillojnë aftësitë e tyre të menduarit dhe të shkruarit.

Roli i mësimit

Mësuesit janë lidhja ndërmjet nxënësve dhe njohurisë. Ata janë hallka e parë e zinxhirit në këtë proces, ajo u jep atyre mundësinë të jenë udhëheqësit e mësimit dhe gjithashtu u jep atyre autoritetin që mundësojnë rritjen e aftësive të mësuarit të pavarur të nxënësit. Për t'iu mundësuar nxënësve që t'i shijojnë dhe t'i vlerësojnë tekstet letrare dhe të zhvillojnë aftësinë e tyre të menduarit kritik, kreativitetit dhe shprehjes së vet, mësuesit nxiten që:⁸

- negociojnë lidhur me qëllimet dhe përmbajtjen e të mësuarit; duke e mbajtur aktiv të mësuarit pozitiv dhe të harmonishëm.
- të marrin pjesë së bashku dhe të shprehin idetë dhe pikëpamjet e tyre.
- Të veprojnë si një model leximi të letërsisë
- Ta përshtatin mësimin sipas reagimeve të nxënësve.
- të rrisin ndërveprimin cilësor në klasë

⁷ Ibid.

⁸<http://www.edb.gov.hk/attachment/en/curriculumdevelopment/kla/engedu/Curriculum%20Document/LitEngCAGuide.pdf>

- Sigurimi i skelave të përshtatshme dhe reagimet cilësore; dhe
- Promovimin e të mësuarit me vetë-qasje.

Hulumtimi thekson se roli i mësuesit në klasë është shumë i rëndësishëm pasi ata shtojnë arritjet për sa i përket realizimit të mësimit dhe mësimdhënies së gjuhës së huaj. Roli i mësuesit është më i madh se programi apo metodat e përdorura në klasë. Mjedisi i mësimit mund të jetë më ideal nëse ua ofron nxënësve mundësinë për të zbuluar letërsinë dhe shqyrtimin e situatave të reja të ngritura. Mësuesit mund të jenë ndihmës në vend që të jenë lektorë apo trajnerë, duke u siguruar studentëve situata ku ata duhet të kenë stimulime të ndryshme dhe shembuj më praktikë.

Pika më e rëndësishme në mësimin e letërsisë është se mësuesit duhet të jenë të vetëdijshëm për objektivat e letërsisë mësimore dhe duhet të bëjnë zgjedhjen specifike dhe adekuate të letërsisë së përdorur. Lidhur me këtë, Purves⁹ ndan rolin e mësuesit të letërsisë në serinë e objektivave si më poshtë:

- mësuesi duhet t'i ofrojë çdo nxënësi sa më shumë vepra të ndryshme të jetë e mundur,
- mësuesi duhet të nxisë çdo nxënës për t'u përgjigjur në mënyrë të plotë
- mësuesi duhet të inkurajojë nxënësin për të kuptuar se pse ai përgjigjet në atë mënyrë
- mësuesi duhet të inkurajojë nxënësit të kenë mundësi të përgjigjen në sa më shumë vepra që është e mundur
- mësuesi duhet të inkurajojë nxënësit që të tolerojnë përgjigjet që ndryshojnë prej përgjigjeve të tij

⁹ Alan C. Purves, *How Porcupines Make Love*. Massachusetts. Xerox College. Publishing, 1972.f. 25.

- mësuesi duhet të nxisë studentët të eksplorojnë, si fushat me të cilat ata pajtohen, si ato me të cilat ata nuk janë të një mendimi.

Në këtë mënyrë, mësuesit janë aktorë të rëndësishëm në procesin e mësimin, ata duhet të inkurajojnë nxënësit që të diskutojnë, të imagjinojnë, të lexojnë dhe analizojnë tregimet e lexuara. Mësuesit duhet të organizojnë aktivitete të ndryshme për të vënë të gjitha tekstet e mësuara në praktikë si: nëpërmjet improvizimeve teatrale, me prozë, me pantomimë dhe të ofrojnë mënyra të tjera fleksibile dhe kreative në menaxhimin e klasës në mënyrë që të motivojnë nxënësit dhe rrisin vlerësimin e letërsisë. Për shkak të mungesës së interesit në letërsinë nga ana e studentëve, efekti i rëndësishëm bie mbi mësuesit.

Kjo është për shkak se mësuesit shpesh nuk përdorin librat e duhura; për nxënësit objektivat e mësuesit nuk janë të arritshme me atë që mësojnë në klasë; mësuesit e kuptojnë tekstin në përvojën e tyre, por nuk janë fleksibël ndaj pikëpamjeve të ndryshme dhe kontekstit që studentët mund ta keqkuptojnë tekstin; dhe teprimi në dhënie e informacionit është një tjetër kurth për mësuesit, pasi kjo mund të shpjerë në një "fokus" të gabuar Alm¹⁰ cituar në Talif.¹¹ Arritjet e studentit në klasë varen shumë nga mësimdhënësi, nga mënyra e mësimdhënies dhe nga sendërtimi i metodave të ndryshme të mësimdhënies. Duhet të ketë një ekuilibër mes mësimëve, i cili arrihet nga mësuesi ndërsa nxënësit dëgjojnë informacione të reja dhe ndjekin mësimë interaktive të cilat inkurajojnë nxënësit që të mësojnë dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në klasat interaktive.

¹⁰ Richard S.Aim, "Goose Flesh and Glimpses of Glory". Në: *English Journal* 52, 1963.

¹¹ Talif Rosli, *Teaching literature in ESL the Malaysian context*, Kuala Lumpur: Penerbit Universiti Pertanian Malaysia, 1995.

Norling¹² argumenton, se një nga mënyrat për të realizuar një mësimdhënie efektive është që ata t'u japin nxënësve hapësirë për atë se çfarë ata dëshirojnë të lexojnë në situata të jetës reale. Mënyrë për të arritur këtë, ai/ajo ata duhet "të trajnojnë mendjen e lexuesve", të zhytet në botën e shkrimtarit dhe ta vënë veten në vendin e tyre. Me fjalë të tjera, në mënyrë që të kuptojnë më mirë një tekst, nxënësit duhet të inkurajohen që të lexojnë me një thjerrëz - me një thjerrëz të një karakteri të veçantë ose të shkrimtarit për të kuptuar më mirë se çfarë janë duke lexuar. Pas kësaj, mësuesi duhet të ketë aftësinë për të lëvizur përmes së kaluarës, lidhur me çështjen e "jo-amtarësisë", dhe të bëjnë tekstet e përshtatshme për studentët që jetojnë në botë krejtësisht të ndryshme me ato që janë të detyruar të lexojnë. Për më tepër, kjo është një mënyrë për të përmirësuar vetëdijen letrare.

Rezultati i përmendur më lart, është një tregues i rolit të rëndësishëm që luan mësuesi në perceptimin e nxënësve për leximet e caktuara apo temat e diskutuara në klasë. Është e vërtetë që mësuesi duhet të ndajë diskutimin në një mënyrë që i lejon nxënësit të shprehin vetveten dhe të ndërveprojnë me njëri-tjetrin, por gjithashtu duhet të lënë hapësirë për të udhëhequr dhe drejtuar diskutimet si figurë autoritare, pa e keqpërdorur autoritetin e vet.

Mbi të gjitha, së pari mësuesi duhet të kuptojë pse mësimi i letërsisë është i rëndësishëm në mënyrë që ata të bëjnë që studentët të kuptojnë qëllimin e këtij procesi në tërësi. Nëse mësuesi mund të shpjegojë qëllimin kryesor pse studentët janë të nënshtruar letërsisë se gjuhës angleze, studentët gjithashtu do të jenë në gjendje të kuptojnë qëllimet e tyre në kurs dhe do të jenë të motivuar në mësimin e tyre.

¹² Ibid.

Përzgjedhja e letërsisë dhe mënyra se si ajo u ofrohet studentëve në klasë është gjithashtu shumë e rëndësishme. Mësuesit duhet ta bëjnë mësimin sa më kreativ duke provuar metoda të ndryshme dhe nuk duhet të lejojnë që nxënësit ta ndiejnë veten të mërzitur në klasë. Mësuesit duhet të jenë në gjendje të përgatisin një klasë të organizuar mirë, ku ndërveprimi midis letërsisë, gjuhës do të sjellë metodën më të mirë për mësimin e gjuhës te studentët.

Për të ruajtur interesimin e studentit drejt mësimin të letërsisë dhe për të rritur aftësinë e tyre të perceptimit kritik dhe estetik, mësuesit duhet t'i japin atij mundësinë e praktikës, me diskutime, pyetje, dhe duke mbrojtur mendimet e tyre të diskutueshme ndaj mendimeve të ndryshme në klasë. Arsyeja kryesore për të bërë këtë është që të ruajnë motivimin dhe interesin e studentëve për të shmangur një orë të mërzitshme me studentë pasivë.

Konkluzioni

Në mënyrë figurative, mësuesi është personazhi kryesor në këtë tregim. Mësuesi luan një rol të rëndësishëm në mënyrën se si letërsia përkapet nga nxënësit në klasë. Kjo varet nga mjedisi i përfutur prej mësuesit për të krijuar një ambient ku studentët pikë së pari të dëshirojnë të vijnë në klasë. Kur kjo sigurohet, ka gjasa dhjetë herë më shumë që studentët të marrin pjesë në të gjitha orët mësimore dhe të investojnë më shumë në arsimimin e tyre. Mësuesi është ai që "orkestron dhe mbështet ndërveprimin e studentëve me tekstin dhe me studentët e tjerë" Kim¹³. Po ashtu çelësi i krijimit të kurrikulumit të duhur është përdorimi i metodave të duhura.

¹³ Myonghee Kim, "Literature discussions in adult L2 learning", në: *Language and Education*, v18 n2, 2004, f. 145-166.

Pasi mësuesi ka krijuar një plan-program për të përmbushur nevojat e nxënësve në vend që të ndjekë kurrikulumet e shurdhëta, të cilat nuk janë edhe aq të përshtatshme, vetëm atëherë studentët ecin tutje me një kuptim solid për letërsinë që u është dhënë atyre brenda periudhës të cilën ata e kalojnë në klasë. Për këtë arsye, gjatë përgatitjes së kurrikulumit është thelbësore që opinionet e teksteve të pëlqehen nga studentët dhe interesi për leximin të merret në konsideratë. Kjo siguron rezultate më të suksesshme dhe një probabilitet më të lartë që shkolla dhe mësuesit të arrijnë qëllimet e vendosura. Tjetra, pikë e rëndësishme për mësuesin, është realizimi i aktivitete për nxënësit, në mënyrë që ata të mund të shprehin se sa shumë dinë dhe në të njëjtën kohë të intrigohen nga ajo që lexojnë.

Mjeti më i rëndësishëm për mësuesit është mundësia për të ofruar njohuri.

Përdorimi i letërsisë autentike në klasë është një nga shtigjet më të mëdha për kultivimin e kësaj urie. Në fund të fundit, për të krijuar këtë mundësi është në dorën e tyre. Megjithatë, mesimdhënësit duhet të kuptojnë se nevojat e nxënësve duhet të vendosen përpara tyre dhe duke përdorur gjykimin e shëndoshë që çdo lëndë të bëhet më funksionale.

Bibliografia

Graddol, David. *The Future of English? A guide to forecasting the popularity of the English language in the 21st century*. The British Council. 2000.

E qasshme edhe në: <https://microsites.bournemouth.ac.uk/business-postgraduate/files/2014/09/CIGBE-The-Future-of-English.pdf> (parë për herë të fundit: 01.10.2015).

Kim, Myonghee. "Literature Discussions in Adult L2 Learning". *Language and Education*. v18 n2 2004. (145-166).

Norling, Teresa. "Aims and objectives in the teaching of English literature at upper secondary school". 2009. E qasshme edhe në: <http://www.diva-portal.org/smash/get/diva2:292256/fulltext01> (parë për herë të fundit: 02.10.2015).

Purves, Alan C. *How Porcupines Make Love*. Massachusetts: Xerox College Publishing. 1972.

Richard S. Aim. "Goose Flesh and Glimpses of Glory". Në: *English Journal*. 52, 1963. (262-268).

Rosli, Talif. *Teaching literature in ESL the Malaysian context*. Kuala Lumpur: Penerbit Universiti Pertanian Malaysia. 1995.

Education first: EF English Proficiency Index 2012. E qasshme edhe në: <http://www.kernvakengels.nl/english-in-54-countries.pdf> (parë për herë të fundit: 01.10.2015).

<http://www.edb.gov.hk/attachment/en/curriculum-development/kla/engedu/Curriculum%20Document/LitEngCAGuide.pdf>

(parë për herë të fundit: 01.10.2015)